


Produkti i Brendshëm Bruto, 2019

Vlerësime finale 2018 dhe gjysmë-finale 2019

Tiranë, më 30 Prill 2021: Në vitin 2019 ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma realë (në volum) prej 2,11%, krahasuar me vitin 2018, pas një rritje prej 4,02 % në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017 .

Fig 1. PBB dhe rritja ekonomike, 2013 – 2019



Sipas të dhënave me baza vjetore, PBB me çmime korrente në vitin 2019 u vlerësua 1,691,729 milion lekë (13.7 miliardë Euro) dhe 1,636,731 milion lekë (12.8 miliardë Euro) për vitin 2018. PBB për frymë në vitin 2019 arriti 593 mijë lekë (ose 4,819 €) nga 571 mijë lekë (ose 4,476 €) që ishte në vitin 2018.

Tab.1 Treguesit kryesorë makroekonomikë (2018-2019 me çmime korrente)

Treguesit	Vitet	
	2018	2019*
Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korrente (në milion lekë)	1.636.731	1.691.729
Të ardhurat kombëtare bruto (në milion lekë)	1.634.740	1.669.585
Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm (në %)	4,02	2,11
Deflatori i PBB (në %)	1,47	1,22
Popullsia mesatare vjetore (në mijë banorë)	2.866	2.854
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Mijë lekë	571
	EURO	4.476
	USD	5.287


2018* Të dhëna finale

2019** Të dhëna gjysmë-finale

Sipas *PBB-së me metodën e prodhimit*, kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë degët e ekonomisë si “Tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor” me 0,65 pikë përqindje, “Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia” me 0,47 pikë përqindje, “Aktivitete profesionale, administrative dhe mbështetëse” me 0,38 pikë përqindje, “Industria gjithsej” me 0,37 pikë përqindje, “Aktivitetet financiare dhe të sigurimit” me 0,31 pikë përqindje dhe “Aktivitetet të pasurive të paluajtshme” me 0,25 pikë përqindje.

Taksat neto mbi produktet kontribuan respektivisht me 0,01 pikë përqindje.

Fig 2. Kontributi i degëve kryesore të ekonomisë në normën reale të rritjes së PBB, në pikë përqindje



Përsa i përket strukturës së PBB-së sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2019 vazhdojnë ta zënë *Shërbimet gjithsej* me 48,4 %, duke shënuar një rritje në terma realë me 3,79 % , *Industria dhe Ndërtimi* përbëjnë 20,6 % të PBB-së, të cilat u rritën në terma realë përkatësisht: *Industria* me 3,04 % dhe *Ndërtimi* me - 2,21 % , *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* përbëjnë 18,4 % të PBB dhe janë rritur me 0,63 % në terma realë.


Deflatori i PBB-së për vitin 2019 ishte 1,22 %.

Sipas *PBB-së me metodën e shpenzimeve*, *Konsumi final* përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 91,24 % , Ky komponent u rrit me 4,33 % në terma nominalë dhe 3,12 % në terma realë. Në strukturën e Konsumit Final është *konsumi final i popullatës ai që zë peshën më të madhe* me 79,11 % , i ndjekur nga *konsumi i administratës publike* me 11,35 % dhe *konsumi i institucioneve jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve (JFSHF)* me 0,79 %.

Në vitin 2019, *Formimi bruto i kapitalit fiks*, i cili përbën 22,29 % të PBB-së, u ul me 3,46 % në terma nominalë dhe 3,68% në terma realë, krahasuar me vitin 2018.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 2,49 % , në terma nominalë dhe me 2,64 % në terma realë, ndërkohë që *Importet e mallrave dhe shërbimeve* u rritën me 2,77 % , në terma nominalë dhe 2,29 % në terma realë, krahasuar me vitin 2018.

Fig 3. Struktura e PBB-së me metodën e Shpenzimeve, në %



Tab 2. Treguesit sipas aktiviteteve ekonomike

A10	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev , 2	Vlerat me çmime korrente Në milion lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)	Struktura e PBB-së (%)		Kontributi
		2018	2019*	2019*	2019*	2018	2019*	2019*
A1	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	301.641	311.130	303.529	0,63	18,43	18,39	0,12
A2	Industria gjithsej	201.251	204.046	207.360	3,04	12,30	12,06	0,37
2a	nga e cila: Industria përpunuese	100.385	105.917	105.925	5,52	6,13	6,26	0,34
A3	Ndërtimi	147.036	144.591	143.792	-2,21	8,98	8,55	-0,20
A4	Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	268.719	284.179	279.357	3,96	16,42	16,80	0,65
A5	Informacioni dhe komunikacioni	46.893	50.009	48.742	3,94	2,87	2,96	0,11
A6	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	37.249	39.430	42.296	13,55	2,28	2,33	0,31
A7	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	89.875	94.737	94.048	4,64	5,49	5,60	0,25
A8	Aktivitete shkencore, profesionale , administrative dhe mbështetëse	106.300	114.061	112.445	5,78	6,49	6,74	0,38
A9	Administrata publike;Arsimi; Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	188.153	197.470	195.865	4,10	11,50	11,67	0,47
A10	Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi	44.442	39.173	38.536	-13,29	2,72	2,32	-0,36
	Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë	1.431.558	1.478.825	1.465.972	2,40	87,46	87,41	2,10
	Taksa neto mbi produktet	205.173	212.904	205.351	0,09	12,54	12,59	0,01
	PBB ME ÇMIMET E TREGUT	1.636.731	1.691.729	1.671.322	2,11	100,00	100,00	2,11

2018 Të dhëna Finale

2019* Të dhëna gjysmë-finale

Tab. 3 Treguesit e komponentëve kryesorë të Shpenzimeve

Treguesit e PBB-së	Vlerat me çmime korente Në Milion Lek		PBB me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)	Struktura e PBB (%)		Kontributi
	2018	2019*	(2019/2018)	2019*	2018	2019*	2019*
Konsumi Final	1.479.510	1.543.611	1.525.744	3,12	90,39	91,24	2,82
Konsumi Final i Popullatës	1.281.812	1.338.334	1.322.399	3,17	78,32	79,11	2,48
Konsumi Final i Administratës Publike	184.731	191.980	190.115	2,91	11,29	11,35	0,33
Konsumi Individual	84.181	88.070	87.728	4,21	5,14	5,21	0,22
Konsumi Kolektiv	100.550	103.910	102.387	1,83	6,14	6,14	0,11
Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse	12.967	13.296	13.230	2,02	0,79	0,79	0,02
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	390.567	377.068	376.197	-3,68	23,86	22,29	-0,88
Ndryshimet e gjëndjeve	779	21.943	22.103		0,05	1,30	
Mospërputhje statistikore	-10.477	-19.598	-25.743		-0,64	-1,16	
Eksporti neto	-223.647	-231.294	-226.979	-1,49	-13,66	-13,67	-0,20
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	516.748	529.638	530.368	2,64	31,57	31,31	0,83
Eksportet e mallrave	125.677	111.511	115.004	-8,49	7,68	6,59	-0,65
Eksportet e shërbimeve	391.071	418.128	415.364	6,21	23,89	24,72	1,48
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	740.395	760.932	757.347	2,29	45,24	44,98	1,04
Importet e mallrave	490.911	498.054	499.258	1,70	29,99	29,44	0,51
Importet e shërbimeve	249.483	262.879	258.089	3,45	15,24	15,54	0,53
PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO	1.636.731	1.691.729	1.671.322	2,11	100,00	100,00	2,11

2018 Të dhëna Finale

2019* Të dhëna Gjysëm-finale

Metodologjia

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Europian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993, Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit ose një tre-mujor). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare.

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë:

- Nomeklatura e veprimtarive ekonomike REV .2 (NVE Rev .2);
- Nomeklatura e produkteve (NP);
- Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP);
- Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT-it ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministrinë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe të tjera. Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë e cila është gjithëpërfshirëse, konsistente, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve, Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave, Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, Anketa e Tregtisë me Pakicë, Anketa e Buxhetit të Familjeve, Anketa e Forcave të Punës, Anketa të Statistikave të Çmimeve, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore, Tatimi mbi vlerën e

shtuar (TVSH), Statistika financiare monetare, Bilanci i Pagesave, Statistika fiskale të qeverisë, Statistika të tregtisë së jashtme, Të dhëna mbi energjinë elektrike dhe të produkteve energjitike, etj.

Fazat e publikimit dhe Politikat revizionuese

Vlerësimet e PBB-së vjetore kalojnë në dy faza llogaritjesh dhe publikimesh.

- Faza e parë përfshin vlerësimet gjysëm-finale të llogarive vjetore të PBB të vitit "t", të cilat kryhen në periudhën t+15 muaj.
- Faza e dytë përfshin vlerësimet finale të PBB të vitit (t). Në këtë fazë rishikohen dhe njëherë të dhënat e vitit (t) kur vjen seti i të dhënave për vitin (t+1) me qëllim që të përfshihet çdo ndryshim i bërë për vitin (t) dhe të sigurohet konsistenca midis dy viteve të njëpasnjëshëm. Gjatë kësaj faze bëhet dhe balancimi final në nivel produkti midis dy metodave të PBB-së.

Të dhënat e publikuara revizionohen mbështetur në politikat revizionuese të llogarive kombëtare. Vlerësimet vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto dhe komponentëve të tij janë subjekt i dy tipeve të revizionimit: të zakonshme dhe të veçanta.

Revizionime të zakonshme:

Revizionimet e zakonshme të PBB-së me baza vjetore janë rezultat i përditësimeve dhe plotësimit të burimeve ekzistuese të të dhënave me informacionin më të fundit për një vit të caktuar "t".

Revizionime të veçanta:

Revizionimet e veçanta vijnë si rezultat i përfshirjes së burimeve të reja të të dhënave statistikore e administrative dhe përmirësimi i atyre ekzistuese, përmirësimi të teknikave statistikore dhe metodave të përpilimit të të dhënave për Llogaritë Kombëtare, ndryshimit të metodologjisë për shkak të standarteve të reja të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA dhe ESA).

Përkufizime

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB): Produkti i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti . Ai është llogaritur sipas dy mënyrave:

- **PBB me mënyrën e prodhimit** , është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktivitetëve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektorëve apo degëve të aktivitetit);

- **PBB sipas mënyrës së shpenzimeve** është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fikse, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

Prodhimi: Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte e shërbime për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proçeset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu, prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

Konsumi i ndërmjetëm: Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh. Ai evidentohet në konsumin e kapitalit fikse.

Vlera e shtuar bruto: Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

PBB nominal mat vlerën e produkteve për një periudhë të caktuar kohore, me çmimet e periudhës në të cilin prodhohet produkti (çmimet e tanishme).

PBB real mat produktin total të prodhuar në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore, por duke marrë parasysh çmimet e një viti bazë (të dhënë-mundet me qenë viti paraardhës ose cili vit caktohet si vit bazë).

Taksat mbi produktet dhe importin: Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa dhe taksa doganore mbi importet.

Subvencione në produkte: Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësite institucionale rezidente.

Konsumi Final: Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo-Fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (IJFSHF).

Konsumi final i familjeve: Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse: Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHF dhe vlerës së prodhimit tregtar.

Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks: Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

Ndryshimi i gjendjeve: Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera, prodhime, punime shërbime në proces, produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, kafshë, etj.

Çmim bazë: Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

Çmimet e tregut: janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

Çmime korrente: Janë çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

Çmime konstante: Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë reale, pra të korrigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.